



MARREVESHJE SIGURUESE

JULIAN ZHELEGU

Ne Tirane, sot me date 12.07.2018 (dy mije e dhjetëdhjetë), para meje Noterit, Noter i Dhomes se Notereve IRANE, u paraqiten personalisht:

- I. Shoqeria tregtare "ALDOSCH" sh.p.k., me Seli ne adrese: Rruga "Qemal Stafa", Banesë Private nr.350., Tirane, e krijuar e vepron ne baze te ligjeve shqiptare, rregjistruar si person juridik me vendim gjykate Nr. 15029 date 30.06.1996, rregjistruar ne Organet Tatimore Tirane me NIPT Nr J76504015S, qe ligjerisht perfaqesohet ketu e meposhte nga perfaqesuesi ligjor z. **Bujar Stafuka**, lindur me 06.05.1963, vendlindja Arameras, Kruje, me Leternjoftim Nr 024453050 dhe Nr.Personal G30506108J, banues ne adresen Rr. "S.Pasha" p. 307, shk. 1 ap. 17, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenes**);
- II. **Banka Credins sha**, person juridik, rregjistruar me vendimin nr. 28969 dt. 31.01.2003, e rregjistruar ne Organet tatimore me Kodin Fiskal nr. 3709529, Nipt. K316088010, si dhe Licensen nr. 16 dt. 31.03.2003 te leshuar nga Banka e Shqiperise, qe ligjerisht perfaqesohet nga Drejtore e Drejtorise se Biznesit Koorporate, **Znj. Stela SPAHIU**, lindur me 26.09.1984, me Leternjoftim Nr. 030307300 dhe Nr.personal I45926089F te njohur personalisht para meje, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Analiste e Kredise Korporate znj. **Orjada BLETA**, lindur me 30.10.1982, me Leternjoftim Nr. 031100430 dhe Nr.Personal I26030035D, te njohur personalisht para meje, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet "**Barremarres**").

Ne kete kontrate, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e nenit. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

Neni 1
Objekti i Kontrates

- 1.1 Krijimi i nje barre siguruese mbi pasurite e luajtshme te **Barredhenesit**, si garanci per shlyerjen e kredise se akorduar nga Banka Credins ne baze te **Kontrates Overdraftit Nr.5998, Nr. 3590/Rep./Nr.206/Kol, Date 17/05/2018**, noterizuar nga **Nota JULIAN ZHELEGU**
- 1.2 **Barredhenesit** vendosi barre mbi kolateralin e pershkruar si me poshte:

- 100% te kuotave dhe te drejtat qe lidhen me to qe Shoqeria tregtare "ALDOSCH" sh.p.k., zoteron ne shoqerine tregtare "GALAXY" sh.p.k., me NUIS J61824005R, me seli ne Rruga "Myslym Keta" ne ambientet e shoqerise "Antibiotik" sh.a., Tirane, si edhe mbi kuotat e reja qe mund te zoterroje ne te ardhmen ne kete shoqeri tregtare.

Neni 2
Baza Ligjore

- 2.1 Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikes se Shqiperise i ndryshuar.

Neni 3
Vlefshmeria

- 3.1 Marreveshja hyn ne fuqi dite e nenshkrimet nga palet dhe mbetet ne fuqi deri ne shlyerjen e plote te kredise se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera te parashikuara, ne kontraten e kredise specifikuar

ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto.

Neni 4 Garancite

4.1 Barredhenesi garanton dhe siguron se eshte pronar legjitim dhe i vetem i kolateralit.

4.2 Barredhenesi garanton Barremarresin se kolaterali, eshte aktualisht i bllokuar ne baze te Marreveshjes Siguruese 5693/1 Date 14.11.2016 Nr 11022 Rep, Nr 3554Kol Date 14.11.2016 noterizuar nga noteri Julian Zhelegu per kredine ne shumen 480.000.000 leke (katerqind e tetedhijete milion leke) per afatin der ne date 14.08.2025.

Neni 5 Detyrimet e barrëdhënësit

5.1 Gjatë kohëzgjatjes së kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, per garantimin e te cilave eshte lidhur kjo marreveshje siguruese, Barrëdhënësi është i detyruar te ruaje, te siguroje dhe te mos lejoje perkeqesimin e situates ligjore dhe financiare te kolateralit te bllokuar ne favor te Barremarresit ne perputhje me keto marreveshje siguruese.

5.2 Barrëdhënësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo fakt dhe rrethanë që mund të rrezikojë/perkeqesoje situaten ligjore dhe financiare te kolateralit dhe ose ekzekutimin e tij.

5.3 Barredhenesi ka detyrimin per te njoftuar Banken per cdo konflikt gjyqesor dhe/ose administrativ ne lidhje me kolateralin objekt i kesaj marreveshje siguruese.

Neni 6 Kompletimi i barres siguruese

- 6.1 Barra siguruese qohet e kompletuar me permbushjen e sa specifikuar ne Ligjin "Per barret siguruese" i ndryshuar.
- 6.2 Barredhenesit me ane te kesaj marreveshje autorizojne Barremarresin te nenshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitoje te gjitha dokumentet e nevojshme ne te gjithë regjistrat perkates te percaktuar nga ligji ku pasqyrohet bllokimi i kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguruese.
- 6.3 Barredhenesit do te paguajne shpenzimet per kompletimin, regjistrimin, depozitimn etj e te gjitha dokumenteve te nevojshme ne te gjithë regjistrat perkates te percaktuar nga ligji per efekt te bllokimit te kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguruese.

Neni 7 Detyrimet e siguruara

7.1 Barredhenesit sigurojne me kolateralin:

- i) Pagimin e detyrimit sipas kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto;
- ii) Kryerjen e te gjitha veprimeve ligjore qe burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne keto marredhenie;
- iii) Pagimin e shpenzimeve per ekzekutimin e kolateralit.

Neni 8 Ekzekutimi i barres siguruese

8.1 Ne rastin kur Kredimarresi eshte ne vonese ne pagimin e kesteve mujore se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet, te parashikuara ne kontraten e kredise te specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, Bankes i lind e drejta per te deklaruar si te kerkueshme per tu paguar te gjithë detyrimet e garantuara me Marreveshjen



Siguruese, si dhe shpenzimet qe perfshijne shpenzimet gjyqesore si dhe cdo shpenzim ligjor deri ne ekzekutimin e plote te tyre, sipas procedurave te parashikuara ne Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

8.2 Barrëdhënësi, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga Banka, do të dorëzojë kolateralin me shpenzimet dhe në përgjegjësinë e tij në çdo vend të përcaktuar nga Banka, bashkë me dokumentet përkatëse. Në rast se Barrëdhënësi nuk e përmbush këtë detyrim, Banka do të vijoj me procedurën e ekzekutimit të parashikuar ne Ligjin "Per Barret Siguruese" i ndryshuar.

Neni 9 **Verifikimi i kolateralit**

9.1 Barremarresi ose agjentet e tij kane te drejte te bejne inspektime dhe te verifikojne kolateralin ne cdo kohe dhe kohe pas kohe, dhe Barredhenesi eshte dakort qe te ofroje gjithe asistencen dhe informacionin e duhur mbi gjendjen ekzistuese apo kushtet dhe rrethanat qe ndikojne mbi te.

Neni 10 **Ndalime qe kufizojne te drejtat qe lindin nga pronesia**

10.1 Barredhenesi nuk ka te drejte te ndryshoje apo te krijojte te drejta pronesie ose te drejta te tjera reale mbi kolateralin, ta perdore ate si kolateral per detyrime te tjera te tashme apo te ardhme, te tyre apo te te treteve pa marre me pare pelqimin me shkrim te Barremarresit.

10.2 Barrëdhënësi nuk ka të drejtë të anullojë, transferojë, të tjetersojë apo disponojë, ne cfaredo forme, kolateralin e barrësuar apo të zvogëlojë vlerën e tij pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

Neni 11 **Vazhdimesia e sigurimit te ekzekutimit te detyrimit**

11.1 Ne rast se kolaterali humbet, demtohet apo zhvlefesohet, si dhe kur Banka çmon se vlera e tij nuk mjafton apo eshte zvogeluar ne vlere, për të mbuluar detyrimin e siguruar nga kolaterali barremarresi ka te drejte te kerkoje shtimin e kolateralit si dhe garanci te plote nga pasuri te tjera te barredhenesit, ndersa Barredhenesi ka detyrimin ta shtojte kolateralin me kerkesen me te pare te Barremarresit.

11.2 Kjo marreveshje siguruese është titull ekzekutiv.

Neni 12 **Mosmarreveshjet**

12.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis paleve si rezultat i kesaj Kontrate zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 13 **Ndryshimet**

13.1 Shtesa, ndryshime nga kjo Marreveshje duhet te behen me shkrim dhe te nenshkruhen nga palet.

13.2 Kjo Marreveshje se bashku me shtesat apo ndryshimet e saj do te jene detyruese per barredhensin dhe trashegimtarete e tyre respektiv.

Neni 14 **Njoftimi Zyrtar midis Paleve**

14.1 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve ne kete marreveshje, do te behen me shkrim te dorezuara personalisht ose me poste te regjistruar (rekomande) dhe/ose adresen e e-mail ne adresen e percaktuar ne kete marreveshje.

14.2 Barredhenesit deklarojne dhe pranojne qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne adresat e deklaruar nga ana e tyre sipas kesaj marreveshje do te konsiderohen si te marra nga ai/ata.

14.3 Barredhenesit jane te detyruar qe te njoftojne menjehere çdo ndryshim ne adresen e tyre. Per sa kohe qe ata nuk kane njoftuar adresen e re, njoftimet do te quhen si te kryera dhe barredhenesit nuk kane te drejte dhe heqin dore nga cdo pretendim ne lidhje me njoftimet e bera ne adresen e deklaruar prej tyre sipas kesaj marreveshje.





Kjo Marrëveshje Siguruese hartohet ne 3 (tre) kopje me vlere te barabarte, dhe pasi lexohet dhe gjendet konform vullnetit te lire e te pjete te paleve nenshkruhet si me poshte. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUESE

BARREMARRES

BANKA CREDINS sha
Drejtore e Drejtorise se Biznesit Korporate
Stela SPAHIU

Stela Spahiu

Analiste Kredie
Orjada BLETA

Orjada Bleta



NOTER

BARREDHENES

Shoqeria tregtare "ALDOSCH SH.P.K
Perfaqesues Ligjor
Bujar STAFUKA

Bujar Stafuka

JULIAN ZHELEGU

Julian Zhelegu